



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 190, Datë 06.06.2023

MBI

**RINOVIMIN E LICENCËS SË SHOQËRISË “RENNGY TRADING GROUP” SH.P.K.,
NË VEPRIMTARINË E FURNIZIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, gërma “d” të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 4, pika 1, gërma “d”, nenit 5, pika 1, gërma “d”, si dhe neneve 10 dhe 16 të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar; si dhe nenit 15 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96 datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 06.06.2023, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqytjes me nr. 1356/4 prot., datë 01.06.2023, “Mbi kërkesën e shoqërisë “ReNRGY Trading Group” sh.p.k., për rinovimin e licencës në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 245, datë 26.11.2018”,

Konstatohet se:

- Shoqëria “ReNRGY Trading Group” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1356 prot., datë 02.05.2023, aplikoi për rinovimin e licencës në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike dhe me vendimin nr. 167, datë 15.05.2023, bordi i ERE-s vendosi të fillojë procedurën për rinovimin e licencës sipas kërkesës së protokolluar në ERE, për një afat 5-vjeçar.
- ERE botoi njoftimin në median e shkruar për fillimin e kësaj procedure (në datat 17.05.2023 dhe 18.05.2023) dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve nga të tretët (data 26.05.2023), nuk rezultoi të ketë të tilla. Njoftimi për fillimin e procedurës u botua edhe në faqen zyrtare të internetit të ERE-s.
- Me shkresën nr. 1356/3 prot., datë 17.05.2023, ERE iu drejtua shoqërisë duke i njoftuar fillimin e procedurës së rinovimit të licencës
- Në zbatim të përcaktimeve të Rregullores “Për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë

elektrike” e ndryshuar, aplikanti duhet të depozitojë në ERE: formatin e plotësuar të aplikimit, sipas Shtojcës 1; çdo modifikim ose ndryshim të mundshëm të dokumentacionit të të dhënave teknike apo dokumentacionit tjetër të depozituar në aplikimin për pajisje me licencë; informacion mbi ushtrimin e veprimtarisë e licencuar (kontrata për shitblerjen e energjisë, nëse ka pasur); shtojca 1/I; si dhe duhet të ketë kryer pagesën e aplikimit dhe pagesat e rregullimit në ERE.

- Nga shqyrtimi i këtij aplikimi rezulton se shoqëria “ReNRGY Trading Group” sh.p.k. ka plotësuar tërësisht dokumentacionin e kërkuar si vijon:
Neni 16, pika 1, gërmat “a”, “b” dhe “c”. **Plotësuar**
Neni 16, pika 7. **Plotësuar**
- Shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit në zbatim të përcaktimeve të Aneksit A të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licensave në sektorin e energjisë elektrike” e ndryshuar, dhe ka shlyer ndaj ERE-s të gjitha detyrimet për sa i përket pagesave të rregullimit.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të rinovojë licencën e shoqërisë “ReNRGY Trading Group” sh.p.k., në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar, duke filluar nga data 27.11.2023.
2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI